

Termt e Referencës

Menaxhimi i Mbetjeve

1. HYRJE

AGSco është një ofruer i shërbimit të mirëmbajtjes së Gazsjellësit, që ushtron aktivitetin në kuadrin e Tregut Shqiptar të Gazit .Duke pasur parasysh veçantitë e biznesit dhe shërbimeve që ofrohen nga AGSco, Shoqëria duhet të nënshkruajë një marrëveshje në bazë të legjislacionit shqiptar për menaxhimin e mbetjeve, për deponimin e mbetjeve të saj dhe mbetjet që krijohen nga aktivitetet e Klientit.

Kontraktori që do të ketë të drejtën e nënshkrimit të Kontratës, do të jetë përgjegjës për të siguruar që Përmbajtja e këtij objekti të shërbimeve do të zbatohet nga punëtorët e tij, si dhe nga të gjithë nënkontraktuesit që do të përfshihen në ofrimin e shërbimeve.

2. OBJEKTI I SHËRBIMEVE

2.1 Kërkesat për Kontraktorin fitues si dhe nënkontraktuesit/subjektet e tij, me te cilët ka nënshkruar kontrata për realizimin e shërbimit të grumbullimit, ruajtjes, riciklimit, përpunimit dhe asgjësimit.

Për realizimin me sukses të objektit të kësaj kontrate, Kontraktori fitues përpara se të nënshkruajë Marrëveshjen kuader duhet të dorëzojë dokumentacionin e kërkuar në shtojcën 8 të DT, pikat 2.2.5 dhe 2.2.6.

Kontraktori do të plotësojë gjithashtu edhe Listën e Menaxhimit të Mbetjeve në bazë të kontratave, për përmbushjen e të gjithë ciklit të plote të menaxhimit të integruar të mbetjeve si dhe të gjitha të dhënat e tjera të përcaktuara në shtojcën 2, bashkëlidhur termave të referencës. Kontratat me subjektet e tjerë do të jenë të shoqëruara me kopje të licencave dhe lejet mjedisore.

Nëse gjatë periudhës të zbatimit të MK, Kontraktorit mund të lind nevoja e ndryshimit të ndonjërit prej subjekteve me të cilin ka një kontratë menaxhimi mbetjesh të integruara Kontraktori duhet të marrë paraprakisht miratimin nga AGSco.

Çdo kontratë e përfshirë në listën e mësipërme do të ketë një kohëzgjatje të përshtatshme për të mbuluar kohëzgjatjen e marrëveshjes që do të vendoset në funksion midis AGSco dhe Kontraktorit.


2.1. Kërkesat e kontratës dhe objekti i aktiviteteve

Kontraktori do të jetë përgjegjës për aktivitetet e mëposhtme:

- Largimin e mbetjeve nga ambientet e AGSco dhe Klientit.
- Transportin e mbetjeve në një impiant /objekt të licencuar për mbetjet
- Marrjen, përpunimin, deponimin/ riciklimin e mbetjeve
- Lëshimin e certifikatave dhe shënimeve të transferimit dhe plotesimin e të gjithë dokumenteve që kërkohen me ligji dhe nga procedurat e AGSco dhe Klienti.

Aktivitetet do të kryhen sipas parimeve të përcaktuara në kapitullin "Menaxhimi i mbetjeve" të dokumentit AGSco-STD-001 "Standardet e SHSM për Kontraktuesit". Zbatimi i këtyre parimeve duhet të konsiderohet i detyrueshëm edhe për të gjithë nënkontraktuesit e përfshirë në aktivitetet, duke përfshirë objektet / impiantet e deponimit të mbetjeve.

Aktivitetet mund të kërkohen sipas një skemë rutinë javore/mujore dhe/ose sipas thirrjeve në tre vendndodhjet e AGSco/TAP. Njesite e AGSco janë (Zyrat qendrorë të Tiranës, Qendra e Mirëmbajtjes Korçë, Njesia Fier, Njësia Çorovodë) dhe vendpunimet e Klientit janë Stacioni i kompresorit Fier, stacioni i matjes Bilisht, Stacionet e Bllok – Valvulave të tubacionit, Qendra e Mirëmbajtjes Berat). Përveç vendndodhjeve të listuara më sipër, vende të tjera mund të komunikohen me vonë nëse do të jetë e nevojshme. Por në çdo rast këto vendndodhje do të jenë brenda gjurmës së Gazsjellësit TAP (Klientit të AGSco) i shtrire në tre qarqet e mëposhtme.



2.2.1 Kategoritë e mbetjeve

Kontraktori do të jetë përgjegjës për transportimin dhe transferimin në objektet përfundimtare e duhura të mbetjeve, për mbetjet e kategorive të mëposhtme:

- Letër dhe karton
- Plastikë
- Metal
- Dru
- Mbetjet e Përgjithshme Urbane
- Ujë të kontaminuar (gjithashtu uji me vaj)
- Vaj i djegur
- Ujë i pijshëm
- Tonerat për printer
- Bateritë e dëmtuara dhe bateritë e harxhuara të pajisjeve;
- Ujëra të ndotura (ujëra të zeza/llum)

- Materiale të tjera të rrezikshme dhe jo të rrezikshm

Informacion më të detajuar per klasifikimet dhe sasitë e vlerësuara jepen në Shtojcën 2

2.2.2 Shërbimet rutinë / Shërbimet me thirrje

- Shërbimet rutinë përfshijnë grumbullimin, dokumentimin, transportimin dhe asgjësimin e kategorive të mëposhtme të mbetjeve:

- Letër dhe karton
- Plastike
- Mbetjet e Përgjithshme Urbane
- Ujëra të zeza/ Ujëra të ndotura

Sipas programit te meposhtem, ku një shërbim rutinë përfshin me shume se nje mbetje.

SHËRBIMET RUTINË/ ROUTINE SERVICES						
Qarku/Region	Mbetja/Waste	Vendndodhja/Location	java/week 1	java/week 2	java/week 3	java/week 4
Qarku FIER /Region FIER	Leter/Paper	ACS03	NO	NO	NO	YES (kg)
	Plastik/ Plastic	ACS03	NO	YES (kg)	NO	NO
	Mbetje Urbane/ Urban Waste	ACS03	YES (kg)	YES (kg)	YES (kg)	YES (kg)
	Ujra te Zeza/Waste Water	ACS03	YES (m3)	NO	YES (m3)	NO
	ROUTINE Call to collect FIER Region/Thirrje ne Qarkun e Fierit			1	1	1
Qarku KORCA /Region KORCA	Leter/Paper	ACS02	NO	NO	NO	NO
	Plastik/ Plastic	ACS02	NO	NO	NO	NO
	Mbetje Urbane/ Urban Waste	ACS02	NO	NO	NO	NO
	Ujra te Zeza/Waste Water	ACS02	YES (m3)	NO	NO	NO
	ROUTINE Call to collect KORCE Region/Thirrje ne Qarkun e Korces			1	0	0

- Shërbimet me thirrje përfshijne grumbullimin, dokumentimin, transportimin dhe deponimin/ riciklimin të kategorive të mbetjeve në Shtojcën 2. Ky shërbim do të përfshin një tipologji ose tipologji të ngjashme mbetje në një vendndodhje të caktuar dhe do të kryhet në marveshje me kompaninë.

2.2. Detyrimet e Kontraktorit

- Zbaton kërkesat e përcaktuara në Procedurën e Kontrollit të Mbetjeve të AGSco dhe Klientëve të AGSco dhe në legjislacionin kombëtar në fuqi;
- Siguron, përmes një laboratorit të akredituar, shërbimin e karakterizimit të mbetjeve, kur kërkohet nga AGSco / ligji;
- Siguron kopje të lejeve ose liçencës nga autoritetet kompetente, me ane te cilave ai të marri, transportojnë, përpunojnë dhe azgjesojnë mbetjet, për të gjitha palët e përfshira nëpërmjet një kontrate;
- Siguron, përsa i përket kompetencës së tij, përgatitjen e të gjitha dokumenteve që kërkohen me ligj në lidhje me largimin, transportin dhe azgjësimin e mbetjeve;
- Eshte pergjegjes per te caktuar Personin Përgjegjës për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë (PPSHSP).
- Siguron personel kompetent, kualifikuar në mënyrë të përshtatshme, të aftë dhe me përvojë për të kryer Shërbimet.

- I Siguron personelit të mirëmbajtjes së tyre, veshje mbrojtëse dhe pajisje sigurie në përputhje me standardin HSE të Kompanisë.
- Sigurohet që i gjithë personeli do të ndërmarrë një Trajnim Fillestar të udhëhequr nga Kompania/Klienti në Objektet e Kompanisë/Klientit përpara fillimit të Shërbimeve. Trajnim Fillestar parashikohet të zgjasë maksimumi tre (3) orë, me një rifreskim çdo vit pas kësaj.
- Siguroni kopje të dokumentacionit të mbetjeve (d.m.th. 4 kopje të dokumentit të transferimit të mbetjeve) për çdo ngarkesë të marrë nga AGSco dhe Klientit duke konfirmuar dorëzimin në destinacionin përfundimtar të mbetjeve.
- Kur kërkohet nga AGSco, secili Transportues i Mbetjeve duhet të sigurojë prova të dokumentuara, me anë të të cilave konfirmohet se automjetet që transportojnë mbetje janë në përputhje me kërkesat e legjislacionit kombëtar në fuqi;
- Kur kërkohet nga AGSco siguron raportin/deklarimin e mbetjeve tek autoritetet.
- Përgatit çertifikatat e deponimit përfundimtar nga objekti i marrjes së mbetjeve tek Kontraktori, AGSco dhe Klienti i tij;

Kontraktori do të ketë përgjegjësinë për të siguruar që detyrimet e përmendura më lart do të përmbushen gjithashtu në të gjithë zinxhirin e kontraktimit.

I gjithë procesi i lëvizjes së mbetjeve nga zonat e përkohshme të depozitimit të mbetjeve ose çfarëdo pike tjetër e grumbullimit të mbetjeve nga transportuesi i mbetjeve shoqërohet me dokumentin për transferimin e mbetjeve, i cili plotësohet sipas klasifikimit/karakterizimit me kodin EËC (Kodi Europian i Mbetjeve) dhe dhe çdo dokumentacion tjetër që kërkohet sipas legjislacionit kombëtar.

Përshatshmëria dhe mjaftueshmëria e burimeve të brendshme dhe të jashtme të Kontraktuesit për menaxhimin e mbetjeve i nënshtrohet verifikimit të përputhshmërisë nga AGSco dhe Klienti i tij. Të paktën, çdo vit, departamentet e QHSE (Cilësia, Shëndeti, Siguria & Mjedisi) i të dy Kompanive mund të kryejnë kontroll në ambientet e transportuesve të mbetjeve dhe marrësve të mbetjeve të palëve të treta, në mënyrë që të verifikojnë nëse standardet e AGSco dhe të Klientit të tij janë në përputhje me kërkesat e legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar në fuqi, duke përdorur një listë specifike të inspektimit.

2.3. Karakterizimi i mbetjeve

Kur është e nevojshme, Kontraktori siguron, përmes laboratorëve të akredituar të analizave të një pale të tretë, karakterizimin e saktë të mbetjeve.

Pas kryerjes së analizës, laboratorit i akredituar i palës së tretë lëshon çertifikatat përkatëse, që përmbajnë të paktën:

- Referencën për AGSco ose njësinë e saj territoriale të Klientit që ka krijuar mbetjet;
- Kodin Evropian të Katalogut të Mbetjeve (EËC);
- Përshkrimin e zgjeruar të mbetjeve (që nuk kufizohet në emrin zyrtar të EËC);
- Metodën e marrjes së mostrave. Mostrat mund të mblidhen nga:
 - Personeli kompetent i Kontraktorit të shërbimit;

- Personeli kompetent i laboratorit;
- Personeli i AGSco. Në një rast të tillë, procedurat e marrjes së mostrave të shërbimeve dakordësohen me laboratorin që do të kryejë analizën dhe Kontraktori i Shërbimit do të lehtësojë procesin.
- Çdo parametër të analizës, metodën e lidhur me analizën, pasigurinë lidhur me matjen dhe vlerën kufi të referencës, aty ku është e pranishme;
- Një deklaratë përfundimtare që duhet të përmbajë:
 - kodin e saktë EËC që do t'i atribuohet mbetjeve në bazë të procesit të prodhimit të treguar nga AGSco;
 - rezultatet e analizave;
 - në rastin e mbetjeve të rrezikshme, kategoritë perkatese të rrezikut;

2.4. DORËZIMET E KONTRAKTORIT

Kontraktori duhet t'i dorëzojë AGSco-së, brenda afateve të rëna dakord:

- Për mbeturinat e terhequra me thirrje:
 - Pas Kërkesës së Kompanisë për kuotim dhe përpara se të merrni konfirmimin për shërbimin:
 - ✓ Propozimi i përgatitur sipas cmimeve të kontratës.
 - Pas konfirmimit nga Kompania për shërbimin e kërkuar:
 - ✓ Siguroni një listë të pajisjeve dhe personelit me një kopje të të gjitha certifikatave (p.sh. trajnimet dhe certifikatat për personelin; certifikatat, raportet e inspektimit të palëve të treta, certifikatat e kalibrimit, librat e mirëmbajtjes, etj.)
 - ✓ Përgatit dhe firmos:
 - Lejen e punës sipas procedurës së Klientit
 - Mbledhja para fillimit të aktivitetit (Tool box Talk)
 - Raporti përfundimtar me dëshmi të aktivitetit të kryera
- Dita e parë e punës e çdo muaji, lidhur me të gjitha shërbimet, Kontraktori do t'i japë një raport Kompanisë. Si minimum, raporti duhet të përmbajë:
 - Situata e përgjithshme e kontratës:
 - ✓ Për çdo "Zë" në kontratë, situata në lidhje me sasinë e përdorura, sasinë e angazhuara, sasinë e disponueshme etj.
 - ✓ Situata e përgjithshme e HSE KPI (Treguesit kryesorë dhe të vonuar) STD
 - Aktivitetet e kryera gjatë muajit të kaluar:
 - ✓ Të gjitha dokumentet për faturën e Shërbimit:
 - Propozimi i fundit i miratuar
 - Faturë me shërbimet e detajuara
 - Raporti Përfundimtar i Aktivitetit
 - Dokumentat e transferimit të mbetjeve
 - Në fund të ciklit, Kontraktori duhet t'i dorëzojë AGSco, brenda afateve të përcaktuara me ligj, një kopje të dokumentit të kthimit të dorëzimit (dokumenti i transferimit), të siguruar nga objekti i deponimit të mbetjeve, me anë të së cilës vërtetohet dërgimi i saktë në objektet e duhura të mbetjeve që krijohen nga aktivitetet
 - KPI HSE lidhur me muajin e kaluar

2.4.1. PLANIFIKIMI I AKTIVITETEVE DHE MARRËVESHJA E NIVELEVE TË SHËRBIMEVE

Në mënyrë që të mundësohet një ofrim efektiv dhe efikas i shërbimit të menaxhimit të mbetjeve, para fillimit të aktiviteteve, do të mbahet një Takim Fillestar (Kick off KOM) ndërmjet AGSco Kontraktorit të shërbimeve.

Gjatë Takimit “Kick off” KOM:

- Do të diskutohet Plani HSE (Sigurise se shendetit dhe mjedisit) dhe të gjitha procedurat përkatëse (shih kapitujt vijues). Për më tepër, gjatë të njëjtit takim, një Plan i Menaxhimit të Mbetjeve që do t'i bashkangjitet Planit HSE (Sigurise se shendetit dhe mjedisit) duke vendosur:
 - Kategoritë e mbetjeve që konsiderohen të prodhuara në mënyrë rutine/thirrje;
 - Frekuenca dhe vendet e largimit të mbetjeve rutinë;
 - Aspektet operacionale për aktivizimin e shërbimit;
 - Marrëveshjet sipas kriterëve specifike të shërbimit për mbetjet jo-rutinë;
 - Informacioni minimal që përmbahet në faturë.

2.5. SHSM (SHËNDETI, SIGURIA & MJEDISI)

Kontraktori zbaton të gjitha kërkesat e legjislacionit shqiptar, me referencë të veçantë, por pa u kufizuar në:

- Ligjin Nr. 10.237 datë 18.02.2010 për “Sigurinë dhe Shëndetin, në Punë”;
- Ligjin shqiptar për zbatimin e Marrëveshjes për Transportin Rrugor të Mallrave të Rrezikshme (Rregullorja ADR);
- Kuadrin Ligjor për “Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, Ligji Nr. 10463 datë 22.09.2011.

Gjithashtu, Kontraktori do të zbatojë:

- Keresat e dokumentit “Standardet minimale të SHSM të AGSco për Kontraktoret” që është e zbatueshme për aktivitetet e tij dhe ofrohet së bashku me këtë objekt të shërbimeve.
- Politikat e klientit të AGSco, kur aktiviteti zhvillohet në vendpunimet e Klientit.
- I gjithë personeli i Kontraktorit do të zbatojë rregullat e sjelljes që përcaktohen brenda AGSco dhe objekteve të klientit AGSco përmes planeve, procedurave, udhëzimeve të punës, standardeve, komunikimeve dhe materialeve informative.

Të gjitha procedurat përkatëse do të sigurohen para nënshkrimit të kontratës dhe në çdo rast para hyrjes në vendpunimet operative.

Përveç të gjitha veprimeve që kërkohen për zbatimin e Legjislacionit shqiptar në lidhje me sigurinë e shendetit dhe mjedisin, Kontraktori i kërkohet të përgatisë para fillimit të aktiviteteve, një plan specifik të SHSM dhe Dokumentin e Vlersimit të Riskut i cili duhet të koordinohet me planin specifik të AGSco, që përmban masat në funksion për të adresuar rreziqet lidhur me shëndetin, sigurinë dhe mjedisin të lidhura me kryerjen e këtyre Shërbimeve. Përveçse sa përmendet në AGSco-STD-001, Plani i SHSM-së:

- përcakton veprimet që duhen të merren për të kontrolluar ato rreziqe në një nivel të pranueshëm, me referencë të veçantë për:
 - Shëndetin, sigurinë dhe mjedisin në punë;

- Sigurinë e transportit rrugor;
- Sigurinë e fazës së ngarkim / shkarkimit;
- përfshin një listë të të gjithë personelit të trajnuar dhe kompetent, të angazhuar në kryerjen e punës;
- përshkruan zbatimin e dispozitave të AGSco dhe klientëve të AGSco, në të gjithë zinxhirin e nënkontraktimit;
- përcakton organizimin dhe përgjegjësitë e QHSE-së;
- përcakton menaxhimin e aspekteve mjedisore.

Kontraktorit mund t'i kërkohet të monitorojë treguesit kryesorë specifikë të performancës çdo muaj, sipas një modeli që do të jepet para fillimit të aktiviteteve.

Kontraktori duhet të dorëzojë, së bashku me kopjen e listës së personelit, të gjitha certifikatat përkatëse të trajnimit, të lëshuara nga një organ / autoritet / ent kompetent dhe i licencuar, për të gjithë personelin që do të përfshihet në ofrimin e shërbimeve, madje edhe në të gjithë zinxhirin e tij nënkontraktues.

Kontraktori është përgjegjës për përditësimin e të gjithë dokumentacionit HSE në lidhje me personelin dhe pajisjet e tij në sistemin AGORA sipas Njoftimeve të Sistemit (d.m.th. datat e skadimit të certifikatave të personelit) Kompania do t'i ofrojë një trajnim përfaqësuesit të HSE të Kontraktorit.

2.5.1. AUTOMJETET

Të gjitha dispozitat e përgjithshme të përcaktuara nga AGSco-STD-001 janë në funksion.

Kërkesa në lidhje me IVMS të dokumentit AGSco-STD-001 "Standardi minimal i SHSM për kontraktuesit" është hequr. Megjithatë, Kontraktuesi do të zbatojë dispozitat e AGSco dhe Klientit të AGSco në lidhje me politikat e sigurta të drejtimit të automjetit.

Automjetet e transportimit të mbetjeve duhet të jenë certifikuar si duhet sipas legjislacionit shqiptar, për të transportuar mbetjet, dhe duhet të jenë:

- të përshtatshme për mbetjet që transportohen
- të pajisur si duhet për të parandaluar rrjedhjet ose derdhjet (madje edhe me kitet e përshtatshme të derdhjes)
- të mbuluara për të parandaluar perhapjen dhe humbjen e mbetjeve gjatë transportit

Të gjitha automjetet duhet të jenë të përshtatshme sipas qëllimit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, në veçanti duke iu referuar:

- Kodit Rrugor Shqiptar;
- Ligjit shqiptar për zbatimin e Marrëveshjes për Transportin Rrugor të Mallrave të Rrezikshme (Rregullorja ADR);
- Ligjet shqiptare për menaxhimin e mbetjeve.

2.5.2. LEJA E PUNES

Kur shërbimet ofrohen në ambientet e Klientit, kontraktuesi do të kryejë Shërbimet në përputhje me Lejen e Punes së Kompanisë dhe të Klientit. Parimet kryesore të sistemit PTË do të përfshijnë:

- Shërbimi kryhet në përputhje me praktikat më të mira të industrisë
- Duhet të ndërmerret një vlerësim i rrezikut për të gjitha aktivitetet që do të kryhen
- Rrjedha e procesit dhe numri shoqërues i hapave të autorizimit duhet të jenë në përpjesëtim me rrezikun (shëndetin dhe sigurinë) e aktivitetit që do të kryhet.

Individët do të ndërmarrin vetëm punë për të cilat janë konfirmuar se janë kompetentë. Procesi PTË do të kryhet duke përdorur një mjet elektronik (MOËO). Kontraktori është përgjegjës për përgatitjen e PTË-së dhe ngarkimin, në sistem, të të gjitha dokumenteve të kërkuara. Informacione të mëtejshme jepen brenda AGSco-STD-001 “Standardi minimal HSE për Kontraktorët”.

2.5.3. SISTEMI I MENAXHIMIT TË QHSE-SË (CILESIA, SHËNDETI, SIGURIA, MJEDISI)

Kontraktori duhet të ketë në funksion një sistem të menaxhimit të QHSE-së bazuar në:

- ISO 9001
- ISO 14001
- ISO 45001

Kontraktori duhet të sigurojë kopje të Çertifikatave të vlefshme të lidhura me fushën e shërbimeve që do të ofrohen

2.6. KËRKESAT MINIMALE TEKNIKE PËR REZERVUARIN E KONDENSIMIT

Sa i përket ujërave të zeza, dy pikat që duhet të mblidhen janë në stacionin e kompresorit Fier (ACS03) në zonën e Semanit dhe në stacionin e matjes Bilisht (ACS02), me volum maksimal gropa 1 përafërsisht 13m³ gropa 2 përafërsisht 6 m³.

Detajet e mëtejshme teknike për sa i përket lidhjes midis rezervuarëve dhe kamionit do të vihen në dispozicion në Takimin Fillestar (Kick off KOM).

3. TARIFAT

Kontraktori duhet të sigurojë një vlerësim ekonomik për shërbimet sipas modelit që i bashkëlidhet këtij qëllimi të shërbimeve në Shtojcën 2.

Çmimi për thirrje duhet të jetë gjithëpërfshirës i:

- Largimi i të gjitha mbetjeve nga objektet e AGSco dhe TAP, sipas vendndodhjeve të rajoneve.
- Depozitimi në një objekt/landfill me License/Leje të përshtatshme.
- Menaxhimi i dokumenteve.
- Sësoni fillestar informues;

Sasite e pritshme te sherbimeve te parashikuara dhe të kerkuara janë vetëm orientuese dhe NUK e kushtëzojnë Autoritetin Kontraktor dhe klientin e saj për t'i realizuar ato përgjate periudhës deri në 30/09/2025.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kërkojë më pak apo më shumë nga volumet e parashikuara (por në çdo rast brenda vlerës së përlogaritur të marreveshjes kuadër).

Të gjitha tarifat do të percaktohen ne Shtojcën 2, bashkëlidhur ketyre terma refernce.